



Tabela paraprake e vlerësimit të fakteve/vlerësimit nga monitorimi		Datë: 13.12.2018	Numri i seancës për këtë çështje: në proces
Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 "Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut"- projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërimin e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH).			
<b>A. Informacioni bazë</b>			
Institucioni dhe tema:	Institucioni: Kolegji i Posaçëm i Apelit (këtu e më poshtë KPA). Objekti: Shqyrtimi i ankimit të paraqitur nga Komisioneri Publik, kundër vendimit nr. 32, dt. 05.07.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Alma Brati		
Emri i subjektit të rivlerësimit	znj. Alma Brati		
Pozicioni i punës/ qyteti nëse nuk është Tirana	Gjyqare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.		
A u shty seanca dhe a ishte e arsyeshme kjo shtyrje?	Seanca dëgjimore publike, u zhvillua në intervalin kohor 10:00-12:15, dhe u shty për në dt. 18 dhjetor. Shtyrja e seancës u argumentua me faktin se Komisionerit i duhet kohë për tu njohur me provat. Përpos këtij fakti, seanca në kohëzgjatje vetëm prej 2 orë e 15 min, u ndërpre në një kohëzgjatje të paarsyeshme prej 1 ore, vetëm që trupi gjyqësor të marrë vendimin për shtyrjen e seancës për arsyen e mësipërme.		
A u shpall vendimi apo jo (Ju lutem paraqisni arsyet në mënyrë të përmbledhur)	Vendimi nuk u shpall në seancën publike të ditës së monitoruar, por u shty për dt. 18 dhjetor ora 14:00		
<b>B. Aktorët që marrin pjesë në proces/seanca</b>			
Trupa gjyqësore (emrat)	Natasha Mulaj - Kryesues i trupit gjyqësor; Rezarta Schuetz - Relator i çështjes; Albana Shtylla, Ina Rama dhe Luan Daci - anëtarë të trupit gjyqësor; te pranishëm pa shkëputje deri në përfundim të seancës gjyqësore		
Monitoruesit ndërkombëtarë	Në cilësinë e vëzhguesit ndërkombëtar u paraqit znj. Marie Tuma; E pranishme pa shkëputje deri në përfundim të seancës gjyqësore		
Mbrojtje me avokat apo mbrojtje personalisht (specifikoni)	Mbrojtja u realizua personalisht nga subjekti i rivlerësimit.		
Pala ankimuese (Komisionerët Publik/Subjekti i rivlerësimit) (gjeneralitetet)	Komisioneri Publik relatues i çështjes: Darjel Sina		
Monitoruesi/ja i/e KSHH:	Albana Misja		
Anëtarë të tjerë të publikut të pranishëm?	Numri i anëtarëve nga publiku u konstatua të jetë gjithëpërfshirëse, me rreth 25 persona, përfaqësues të institucioneve publike të interesuara, të shoqërisë civile, Avokatit të Popullit, dhe stafit të këshilltarëve ekonomik dhe ligjor të KPA dhe Komisionerëve Publik, me akses të plotë në hyrjen e godinës dhe pjesëmarrje fizike në seancën dëgjimore. Akomodimi u krye në formë të rregullt nga stafi koordinues i KPA, pavarësisht hapësirës së kufizuar të sallës së gjyqimit.		
Media e pranishme:	Mediat lokale ishin të pranishme, me akses të plotë në hyrjen e godinës. Megjithatë pjesëmarrja e tyre u lejuar vetëm në fazën përgatitore të seancës dëgjimore, pas së cilës iu komunikua nga kryetari i trupit gjyqësor, të largohen nga salla së bashku me mjetet e regjistrimit, referuar Rregullores "Për marrëdhëniet me median".		
C. A vendosi pala ankimuese të parashtror pretendime për të tre kriteret ligjore të Vettingut?	Po/Jo	Në cilat prej 3 kritereve ligjore u ndalua pala ankimuese në prezantimin e shkaqeve të pretendimeve? Specifikoni kërkesat përfundimtare (pretendimet).	Cili është reagimi i subjektit të rivlerësimit ndaj pretendimeve të Komisionerit publik? Specifikoni kërkesat përfundimtare (prapësimet). Specifikoni nëse ka bërë Apel kundërshtues.
	jo	Pala ankimuese, përbërë nga 2 komisionerët publik, pretendoi se janë konstatuar mangësi në gjendjen që janë aktet, sa i takon vlerësimit të pasurisë të subjektit të rivlerësimit. Kërkesat përfundimtare të parashtruara: riceljen e hetimit administrativ. Lënien në fuqi ose ndryshimin e vendimit të KPK	Subjekti i rivlerësimit paraqiti prapësimet e tij duke e cilësuar vendimin e KPK të drejtë, dhe duke kërkuar përfundimisht "lënien në fuqi të vendimit të KPK, që ka vendosur konfirmimin e saj në detyrë". Deklaroj se ka marrë dijeni për Vendimin e ankimit dhe shkaqet e ankimit

D. Përmbytja e çështjes (Vlerësimi i kriterëve)	Prezantimi i pretendimeve/prapësimeve	pala që ka parashtruar pretendimin	A u diskutua? Specifikoni aktet provuese të administruara? Specifikoni barrën e provës ?
D1. Pasuria	<p>Shkaqet e pretendimeve parashtruar nga Komisionerët Publik, lidhur me vlerësimin e pasurisë: 1- Apartament banimi, Tiranë, vlera 80.000 €, pjesë takuese 100%. Burim Krijimi: kredi (50.000€) + Hua nga e tezja (25.000 €) + Kursime personale. Sipas Komisionerit KPK nuk i ka kaluar subjektit barrën e provës lidhur me marrëdhënien e huase që lidh subjektin e rivlerësimit me tezen. Sipas deklaratës noteriale, administruar në dosje, subjekti e ka shlyer plotësisht huanë. Gjithashtu kjo shlyerje është realizuar me kurtime personale të subjektit dhe dhurim nga familja (për të cilët gjithashtu Komisioni nuk ka vërtetuar burimin e ligjshëm të të ardhurave). Sa më sipër Komisioneri vërteton se subjekti ka qenë në pamundësi financiare për shlyerjen e kësaj huaje. Në këtë kriter të rivlerësimit kërkohet: huadhënësi dhe dhuruesi të cilësohen si persona të tjerë të lidhur; të hetohet për te justifikuar ligjshmërinë e burimeve të tyre. Për të vërtetuar burimin e ligjshëm të huasë, Komisioni nuk ka administruar prova, por është mjaftuar me faktin se subjekti ka të ardhura të mjaftueshme në bankë. 2- shtëpi + truall, Durrës, pjesë takuese 25%, vlera rreth 2 milion Lek, Burim krijimi: të ardhurat nga paga. Komisioneri pretendon se sipërfaqja paraqitur në K. Shitjes është e ndryshme me atë të përcjellë pranë Komisionit, si edhe vetë Kontrata në fjalë ndryshon në përmbytje pavarësisht nr të njëjtë Rep dhe Kol. Pretendohet se Komisioni nuk ka verifikuar sa më sipër. 3- Nuk është vërtetuar ligjshmëria e burimit të të ardhurave nga pensioni familjar</p>	Komisioneri Publik	<p>Provat e administruara në seancën dëgjimore: Pozita procedurale e Komisionerit Publik, i rezervon të drejtën të paraqes kërkesë për marrjen e provave që nuk janë administruar nga KPK, pa pasur barrën e provës për të vërtetuar pretendimet e tij.</p>
	<p>Prapësimet paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, kundër shkaqeve të pretendimeve parashtruar nga Komisionerët Publik, lidhur me vlerësimin e pasurisë: 1- apartament banimi, subjekti prapëson se nuk ka akt formal lidhur me huanë për arsye të marrëdhënies së afërt mes subjekteve. Deklaron se tezja ka depozita bankare për të cilat nuk është hetuar lidhur me ligjshmërinë e tyre nga Komisioni dhe as i është kaluar barra e provës. Pavarësisht kësaj kundërshton përgjegjësinë e saj për të vërtetuar këtë ligjshmëri duke ia atribuuar përgjegjësinë bankës. Burimi i krijimit të këtyre depozitave: të ardhura përfituar si emigrante në Greqi (paraqet në efektin e provës, Vërtetime nga M. Ekonomisë, ku pasqyrohen të ardhurat 2000-2017, me qëllim për të vërtetuar që subjekti i huasë është në marrëdhënie pune); sa i takon pretendimit të Komisionerit lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave derivuar nga dhurimi, subjekti deklaron se janë të ardhurat e prindërve të saj, të punësuar prej mëse 16 vjet, pavarësisht se Zyra e Tatimeve Shkodër mban të dokumentuar në sistemin e tatimeve vetëm të ardhurat e 4 vjecarit të fundit. Fakti që formalizimi në sistemin tatimor është hedhur vetëm për dosjet që kanë qenë në gjendje, kjo konsiderohet anomali e sistemit financiar shqiptar për një periudhë të caktuar vitesh. 2- Sa i takon pensionit familjar ushqimor për fëmijët nga ish bashkëshorti, vlera aktuale e pagesës është bërë me marrëveshje mes palëve (si një alternativë ligjore referuar Kodit të Punës), dhe jo me vendim gjyqësor 3- sa i takon shtëpisë në Durrës, vlerat kanë ndryshuar nga 158 m2 që pasqyrohet ne K. Shitjes, në 178m2, si deklarim i grupit të punës mbi azhurnimin që është hedhur në sistem</p>	Subjekti i rivlerësimit	<p>Aktet provuese të paraqitura në seancën dëgjimore nga subjekti i rivlerësimit: 1. Kontratë shitblerje me A.H, 2010, për P.P. të llojit "kullotë", dhe certifikatë pasurie 2. Kopje kërkesë, ku palët kanë paraqitur vullnetin për ndarjen e pasurisë.3. tre foto të pasurisë së mësipërme. 4. Kopje mandat pagese të një pjese të paguar të vlerës së një prej autoveturave.5. Analizë e veprimeve të klientit shpk, automjetin e të cilës ka poseduar me policë sigurimi. 6. Vërtetim pune të shoqatës ku ka punuar bashkëjetuesja e tij, pa datë dhe letër rekomandimi. 7. Udhëzim nga Ministria e Drejtësisë për heqjen e licencës së noterit, të të atit. 8. Leja e ushtrimit të avokatit të të atit 9. Certifikatë personale e familjare 10. Vërtetim ZRPP të regjistrimit të pasurive të paluajtshme ndërtesë, truall dhe garazh 11. Deklaratë nga të afërmit për financim të njërit prej udhëtimeve jashtë shtetit. 12. Regjistrim i ushtrimit të aktivitetit si përkthyes për llogari të bashkëjetueses. 13. Vërtetim pune kryer nga bashkëjetuesja në një OJF, pa përcaktuar pagën.</p>
		Mbrojtja	
		Ankesa nga publiku	Përfaqësuesi i ONM

	z. Daci, anëtar i trupës gjyqese, paraqet pyetjen: nëse korrigjimi në ZRPP Durrës, mbi sipërfaqen e pasurisë në Durrës, është bërë me kërkesë të grupit të punës që realizoj matjet apo të subjektit? Subjekti pranon që çdo regjistrim është bërë me kërkesë të grupi të punës	Relatori	
D2. Figura /Kontaktet me krimin e organizuar		Komisioneri Publik	
		Mbrojtja	
		Subjekti i rivlerësimit	
		Ankesa nga publiku	
D3. Vlerësimi i aftësive profesionale dhe etikës		Përfaqësuesi i ONM	
		Komisioneri Publik	
		Mbrojtja	
		Subjekti i rivlerësimit	
		Ankesa nga publiku	
		Përfaqësuesi i ONM	
E.Konkluzione dhe komente të monitoruesit të KSHH (Vlerësimi paraprak i monitoruesit të KSHH për aspektet e procesit të drejtë ligjor (publiciteti, etika e organeve të vettingut dhe përfaqësuesit të OMN, si e vlerësoni hetimin administrativ, të drejtat e mbrojtjes së subjektit, barazia e mjeteve ligjore, parimi i kontradiktoritetit, koha e arsyeshme, e drejta për të paraqitur prova dhe e drejta për tu dëgjuar, etj.)	Aksesi i pjesëmarrjes, nga publiku, shoqëria civile, institucionet e tjera të interesuara dhe mediat lokale është respektuar. Etika e sjelljes së trupit gjyqes është e rregullt dhe të folurit të kuptueshëm. Elementet procedural të procesit gjyqësor, referuar nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, janë respektuar. Kryetari i trupit gjyqes parashtron procedurën e seancës dëgjimore. i jepet e drejta procedurale subjektit të rivlerësimit për të kundërshtuar pretendimet e Komisionerëve Publik. Njoftohet dhe pranohet në seancë, se ka marrë dijeni lidhur me vendimin dhe shkaqet e ankimit. i rezervohet e drejta e pyetjes vëzhguesit ndërkombëtar dhe trupës gjyqese. Seanca pati një kohëzgjatje të arsyeshme prej rreth 2 orë e 15 min.		